




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Ekstrakt nga procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datë 29.12.2017, ora 10:00, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Vjollca Konjusha, Remzi Shala, Ilir Hasani, Arieta Jashari, Mirvete Gërguri, Jetmir Berisha, Albert Jasharaj, Miranda Shabani, Sabit Bullatovci, Shaban Ademi, Sabri Rexhepi, Ali Zogjani, Naser Graiçevci, Migjen Kolshi, Ariana Zogjani, Aida Alimi, Mehdi Lahu, Durim Hajra, Eglantina Azemi, Doruntina Jashari, Driton Ademi, Betim Ahmeti, Ali Ismaili, Driton Hasolli, Qerim Gara, Bashkim Krasniqi dhe Ljubisa Cirkovic.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Nënkryetarët dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës.

Të tjerë: Përfaqësuesit e OSBE-së, KFOR-it dhe Zyrtari për Informim i Komunës.

Mbledhjen deri në zgjedhjen e Kryesueses së Kuvendit të Komunës e kryesoi z. Qerim Gara, i cili përshëndeti të pranishmit në mbledhje, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi rendin e ditës, me sqarimin që pika e tretë: 'Propozimi për themelimin e Komitetit për Komunitete', të shtyhet për mbledhjen e ardhshme, meqë nuk kemi ende marrëveshje të komunitete për caktimin e përfaqësuesve të tyre.

REND DITE

1. Propozim për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.
2. Propozim për themelimin e Komitetit për Politikë e Financa.
3. Propozim për themelimin e Komitetit për Komunitete.

Kryesuesi i mbledhjes, z. Qerim Gara: Përshëndetje për të gjithë. Sot në rend të ditës i kemi tri pika. Ju njoftoj se Komiteti për Komunitete nuk do të formohet në këtë mbledhje. Pasi që më parë kanë qenë pesë anëtarë nga komunitetet, tani do të jenë katër, sepse ky Komitet do të ketë vetëm shtatë anëtarë, komunitetet ende nuk kanë mundur të bëjnë zgjedhjen e anëtarëve të tyre, andaj kjo pikë e rendit të ditës, duhet të shtyhet deri në mbledhjen e radhës në muajin, janar 2018, me pajtimin tuaj.

Pas sqarimeve, Kryesuesi i mbledhjes, ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës që të deklarohen për rendin e ditës.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e shtatë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesi i mbledhjes konstatoi se Kuvendi i Komunës, unanimisht e aprovoi për shqyrtim rendin e ditës së propozuar dhe shtyerjen e pikes së tretë: 'Propozimit për themelimin e Komitetit për Komunitete', për mbledhjen e muajit, janar 2018.

Pika e parë (1) - Propozim për zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i mbledhjes, z. Qerim Gara: Për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, duhet të formojmë një komision prej tre apo pesë anëtarëve. Unë kërkoj nga tre subjektet politike që ta caktojnë nga një anëtarë për zhvillimin e mëtutjeshëm të procedurave.

Remzi Shala: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Grupi Parlamentar i LDK-së, për anëtarë të Komisionit propozon znj. Arjeta Jashari.

Naser Graiçevci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Grupi Parlamentar i PDK-së, për anëtar të Komisionit propozon z. Migjen Kolshi.

Mehdi Lahu: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Grupi Parlamentar i LVV-së, për anëtar të komisionit propozon z. Durim Hajra.

Pasi që subjektet politike i propozuan tre anëtarët e Komisionit për zhvillimin e procedurave për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Kryesuesi i mbledhjes, z. Qerim Gara, ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës, që të deklarohen për përbërjen e propozuar dhe të votojnë për formimin e Komisionit për zhvillimin e procedurave për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e shtatë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesi i mbledhjes konstatoi se Kuvendi i Komunës, me unanimitet të votave e formon 'Komisionin për zhvillimin e procedurës për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës' në përbërje prej tre anëtarëve: Arjeta Jashari, Migjen Kolshi dhe Durim Hajra.

Kryesuesi i mbledhjes ftoi anëtarët e partive politike, që të japin propozimet e tyre për Kryesues të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës.

Remzi Shala: Grupi Parlamentar i LDK-së, propozon Vjollca Konjushën për Kryesuese të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës. Pasi që propozime tjera nuk pati, Kryesuesi i mbledhjes ftoi Komisionin për Zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit, që të konsultohen dhe më pas të fillojnë procedurat për realizimin e votimit. Komisioni u tërhek për konsultime, përgatiti fletëvotimet dhe u kthye në sallë.

Arjeta Jashari: Përshëndetje për të gjithë. Pas verifikimit të listës, përgatitjes së fletëvotimeve, Komisioni konstaton, se janë realizuar të gjitha kushtet për fillimin e procesit të fshehtë të votimit për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i mbledhjes, z. Qerim Gara: Pas përfundimit të procesit të votimit dhe numërimit publik të votave në sallë, ftoi znj. Arjeta Jashari, zyrtarisht do të komunikoi rezultatin e votimit të fshehtë për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Arjeta Jashari: Në emër të Komisionit raporton se të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës, gjithsej njëzet e shtatë anëtarë morën pjesë në votim. Shtatëmbëdhjetë 17 ishin 'për', nëntë 9 'kundër' dhe 'një' 1 abstënim. Pra, Komisioni, konstatoi se Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, me shumicë të votave, është zgjedhur znj. Vjollca Konjusha.

Kryesuesi i mbledhjes, Qerim Gara: Pas raportimit të Komisionit, konstatoi se Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës me shumicë të votave ka marrë vendim për zgjedhjen e Kryesueses së Kuvendit të Komunës, znj. Vjollca Konjusha.

V E N D I M

Për zgjedhjen e znj. Vjollca Konjusha, e lindur me datë 01.12.1977, në fshatin Lismir të Komunës së Fushë-Kosovës, me profesion mësime dhënëse, në pozitën e Kryesueses së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për mandatin zgjedhor 2017-2021.

Vjollca Konjusha: Përshëndetje për të gjithë. Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës, drejtor të drejtorive, përfaqësues të KFOR-it, OSBE-së dhe Organizatave Jo Qeveritare. Faleminderit për besimin që ma dhatë me vote për Kryesuese të Kuvendit të Komunës, unë do t'i kryej të gjitha detyrat me nderë dhe besnikëri, do të kem bashkëpunim me të gjitha subjektet politike pa anim, shpresoj dhe besoj që puna dhe përkushtimi i të gjithë neve, do të jetë në dobi të qytetarëve tanë të cilët na e besuan votën e tyre. Do të mundohem, të punoj drejtë dhe të jem, sa më transparente me të gjithë qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës. Faleminderit!

Pika e dytë (2) - Propozim për themelimin e Komitetit për Politikë e Financa.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Bazuar në nenin 51, paragrafi 1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040, nenin 34, pika 34.1 shkronja a, nenin 37 të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, është në kompetencën e Kuvendit të Komunës që të themeloj Komitetin për Politikë e Financa, mbështetur në rezultatin zgjedhor të certifikuar nga Komisioni Qendror Zgjedhor me datën 29.11.2017, mbështetur në dispozitat e nenit 4, paragrafi 1 dhe 2, nenit 5, 6, 7, paragrafi 5, të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2014 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunë, Komiteti për Politikë e Financa në Komunën e Fushë-Kosovës do të ketë 7 anëtarë. Ftoi, subjektet politike që t'i japin propozimet e tyre.

Naser Graiçevci: Mbështetur në Statutin e Komunës, Komiteti për Politikë e Financa, do të duhet t'i kishte nëntë anëtarë, ashtu siç ka qenë herën e kaluar.

U sqarua se sipas nenit 7, paragrafi 5, të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2014 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunë, Komiteti për Politikë e Financa në Komunën e Fushë-Kosovës do të ketë vetëm 7 anëtarë.

Aida Alimi: Faleminderit e nderuara Kryesuese, të nderuar kolegë, të nderuar të pranishëm, barazia gjinore është pjesë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë dhe duhet të reflekton mundësi të barabarta të pjesëmarrjes së femrave dhe të meshkujve në jetën politike, ekonomike, kulturore dhe sociale. Unë kërkoj nga të gjitha partitë politike, që të bëjnë respektimin e kuotës gjinore.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Komiteti për Politikë e Financa do të përbëhet nga 7 anëtarë. LDK me 45.39% të votave do të ketë tre anëtarë, PDK me 16.58% të votave do të ketë një anëtarë, LVV me 14.64% të votave do të ketë një anëtar. Subjektet tjera politike: Nisma, AAK, PD dhe AKR me 11.72% të votave do të përfaqësohen me një anëtar, PDAK me 5% të votave do të përfaqësohet me një anëtar. Ftoi, partitë politike që secila prej tyre të japin propozimet e veta.

Remzi Shala: Anëtarët e LDK-së, për Komitetin për Politikë e Financa do të jenë Vjollca Konjusha, unë Remzi Shala dhe Mirvete Gerguri. Njëkohësisht, po flas në emër të PDAK-së, të cilët e kanë propozuar z. Qerim Garën anëtarë të Komitetit për Politikë e Financa.

Naser Graiçevci: Grupi Parlamentar i PDK-së, propozon Aida Alimin që të jetë anëtare e Komitetit për Politikë e Financa.

Mehdi Lahu: Grupi Parlamentar i LVV-së, për Komitetin për Politikë e Financa anëtare e propozon Doruntina Jashari.

Driton Ademi: Nëse bazohemi ne Ligjin për Vetëqeverisje Lokale si dhe në Udhëzimin Administrativ përkatës, i cili, e rregullon këtë çështje, thuhet se përbërja e Komitetit për Politikë e Financa duhet të reflektohet nga përbërja e asamblesë komunale. Në fakt edhe ligji edhe udhëzimi përkatës administrativ i referohen entiteteve politike. Pra, është fjala për entitete politike, ku çdo subjekt politikë është entitet në veti ose në rastin konkret një kualicion që ne në përbërje të asamblesë nuk e kemi. Marrëveshja që u pa në mes të LDK-së dhe PDAK-së duhet të formalizohet, ose do të lidhin kualicion e të shkojnë si një entitet, për ndryshe bien ndesh me udhëzimin administrativ. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e monitoron edhe në kuptimin përkatës e rregullon këtë çështje. Ne do të kërkojmë interpretimin ligjor, nga zyra ligjore e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, sepse duhet të gjindet proporcioni më i afërt i përfshirjes që reflekton përbërjen e asmblesë në kuadër të Komitetit për Politikë e Financa. Ne e kemi një propozim që është dhënë tekstualisht në tekstin që është bërë për këtë takim ku: NISMA, AAK, PD dhe AKR duhet të përfaqësohen me rotacion. Ne sot nuk jemi të gatshëm që të shkojmë në këtë variant, pos tjerash do të jemi në një konsultim të përbashkët, sepse neve na intereson përmbajtja e aktiviteteve që do të përfshihen në kuadër të Komitetit për Politikë e Financa. Mundësisht ka qenë mirë që edhe zyra ligjore nga Komuna ta interpretojë por gjithsesi përshtypjet janë që nuk mund të shkohet me entitete të reja, sepse ne i referohemi rezultatit të fundit që ka dalur nga zgjedhjet.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Ftoi edhe partitë tjera të deklarohen, se a kanë qëndrim tjetër apo ky është qëndrimi i tyre i përbashkët.

Driton Ademi: Unë si asamblist, por edhe në emër të subjekteve tjera politike: të AAK-së, AKR-së dhe PD-së kërkoj që së pari si asamble të definojmë çka është entiteti politikë. Ne e dimë që çdo subjekt është entitet politik, por nuk e kemi të qartë ndërlidhjen e një subjekti politikë me tjetrin. Kurse për propozimet tona duhet të prisni.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim ‘Propozimin për themelimin e Komitetit për Politikë e Financa’, në përbërje: Vjollca Konjusha, Remzi Shala, Mirvete Gërguri, Aida Alimi, Doruntina Jashari dhe Qerim Gara.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota ‘për’, ndërsa dymbëdhjetë anëtarë të Kuvendit të Komunës nuk morën pjesë në votim për arsye të mospajtimeve me procedurën e ndjekur, gjithsej njëzet e shtatë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi ‘Propozimin për themelimin e Komitetit për Politikë e Financa’ dhe mori:

V E N D I M

1. Për themelimin e Komitetit për Politikë e Financa në Komunën e Fushë-Kosovës në përbërje prej anëtarëve si vijon:

- 1 Vjollca Konjusha - përfaqësuese nga Lidhja Demokratike e Kosovës, Kryesuesja e Komitetit;
 - 1.2 Remzi Shala - përfaqësues nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtar;
 - 1.3 Mirvete Gërguri - përfaqësuese nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtare;
 - 1.4 Aida Alimi - përfaqësuese nga Partia Demokratike e Kosovës, anëtare;
 - 1.5 Doruntina Jashari - përfaqësuese nga Lëvizja Vetëvendosje, anëtare;
 - 1.6 Qerim Gara - përfaqësues nga Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës, anëtar.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e Komitetit për Politikë e Financa është shqyrtimi i të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifatat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim gjatë vitit fiskal, si dhe marrjen e raporteve nga Kryetari i Komunës dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

Procesmbajtës

Hasan Gjyrevci



Kryesuesi i mbledhjes

Qerim Gara



Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha

